



DigitAlb

OFERTA FESTIVE

ULJE DERI NË 7,500 Lekë



HENRY KISSINGER
Si të shmangim një luftë tjetër botërore



HYSNI GURRA
Sondazhi që tregon se Belind Këllici është kandidati i duhur për të mundur Vellajin!



VIDEO/ Vrasja e dyfishtë/ RENEA e kapi autorin në një banesë të braktisur

11:17, 16/12/2022



Besnik Pjetri, autori i vrasjes së dyfishtë disa muaj më parë në Lezhë, është vënë në prangat e policisë. SYRI TV mëson se Pjetri është arrestuar nga uniformat blu mëngjesin e sotëm nga forcat RENEA.

Ai u kap në një banesë të braktisur. Policia ka publikuar edhe pamjet e operacionit.

LEXO EDHE:
Vrau ish-vjehrrin dhe ish-kunatin, Pjetri arrestohet pas disa muajsh

Në fund të muajit gusht, Pjetri vrau me armë zjarri ish-vjehrrin dhe ish-kunatin Pjerin dhe Gent Perjaku. Autori i dyshuar i ngjarjes kishte qenë i martuar dhe i divorcuar prej gjashtë vitesh me vajzën e Pjerinit, motrën e Gentit.

Mbrëmjen që ndodhi krimi, babë e bir, sapo ishin kthyer në banesën e tyre, nga një darkë me të afërm të familjes. Dyshohet se mes ish dhëndrit, gruas dhe familjarëve të saj ka pasur konflikte prej vitesh.

NJOFTIMI ZYRTAR

RENEA kap dhe vë në pranga një shtetas shumë të kërkuar për vrasje të dyfishtë me armë zjarri.

Finalizohet operacioni policor i koduar "Fundi i arratisë", i zhvilluar në kushte të vështira terreni dhe atmosferike.

Operacioni, i finalizuar si rezultat i ndërhyrjes profesionale të shërbimeve të RENEA-s dhe punës gjurmuese-policore të strukturave hetimore dhe operacionale të Policisë së Lezhës.

Lokalizohet në një banesë të braktisur në Kaçinar, Mirditë, kapet dhe vihet në pranga 49-vjeçari i shumëkërkuar për vrasje të dyfishtë me armë zjarri.

I ndaluar vrau babanë dhe vëllanë e ish-bashkëshortes së tij, më datë 29.08.2022, në banesën e tyre, në Grykë-Zezë, Lezhë.

Shërbimet e Policisë së Lezhës, në vijim të punës intensive gjurmuese-policore, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për kapjen dhe vënien në pranga të autorit të shumëkërkuar të vrasjes së dyfishtë, me armë zjarri, të ndodhur më 29.08.2022, në Grykë-Zezë, Lezhë, ku u vranë shtetasit P. P., 56 vjeç dhe G. P., 32 vjeç (babai dhe vëllai i ish-bashkëshortes së autorit), mbështetur nga inteligjencia informative, si dhe falë ndërhyrjes profesionale nga shërbimet e RENEA-s, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Fundi i arratisë", të zhvilluar në një terren me kushte tejet të vështira gjeografike dhe atmosferike.

Si rezultat i këtij operacioni, falë kërkimeve të pandërprera dhe ndjekjes intensive, duke përdorur forma dhe teknika speciale hetimi, u bë i mundur lokalizimi në një banesë të braktisur, në fshatin Kaçinar, Mirditë, si dhe kapja e vënia në pranga e shtetasit:

- B. P. (P), 49 vjeç, banues në Troshan, Lezhë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë i ka caktuar 49-vjeçarit, në mungesë, masën e sigurisë "Arrest në burg", pasi nga veprimet hetimore, të kryera nën drejtimin e Prokurorisë së Lezhës, rezultojnë se 49-vjeçari, më datë 29.08.2022, për shkak të një konflikti me familjarët e ish-bashkëshortes së tij, ka vranë me armë zjarri shtetasit P. P. dhe G. P. (babai dhe vëllai i ish-bashkëshortes së tij).

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

©SYRI.net

TabGola Food




Kostoja e transplantit të flokëve në Turqi mund t'ju befasojë

Transplantet e flokëve | lidhje të sponsorizu... | Sponsored



Shikoni sa mund t'ju kushtojnë implantet dentare të gjithë gojës ...

Implantet Dentare | Kërko reklama | Sponsored



Çfarë ka parashikuar Baba Vanga për vitin 2023?

Çfarë ka parashikuar Baba Vanga për vitin 2023? Gruaja e verbër mistike, Baba Vanga ka bërë një listë parashikimesh edhe për vitin 2023. Që kur ishte fëmijë në vit...

Syri | Lajmi i fundit



Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek

megazbritje.al | Sponsored

Lexo edhe:



'Me porosi të Marjetës'/ E vranë dhe i dogjën trupin, zbardhen dëshmitë e dy të arrestuarve



Vodhi katër palë këpucë dhe xhupa firmato, arrestohet 47-vjeçarja shqiptare në Itali



Aksident në rrugën Lezhë-Shëngjin, plagoset shoferi i motorit

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

TË NGJASHME



Krimi horror i 5 viteve më parë/ Si e vrau drejtuesja e fondacionit ortakun e saj për borxhin 1 mln lekë. Trupi i tij u gjet i djegur



EMRI/ Shqiptari futet në banesë për grabitje, i moshuari e plagos rëndë



'Gomonla do ishte shpëtuar më shpejt nëse do të kishte shqiptarë në bord'



EMRI-FOTO/ Aksidenti i rëndë në Tiranë, ja 35-vjeçari që humbi jetën



Angli, burgosen dy burra shqiptarë për serën e kanabisit që viente 250 mijë paund



Vendimi i parë/ Mustafa dënohet me 26 vjet heqje lirie për krime lufte



Krimi monstruo për borxhin/ Marjeta kishte lidhje intime me viktimën

